Breaking News: Tiranë/Zbardhet dinamika e ngjarjes së ndodhur dje, në Bathore, ku mbeti i plagosur me armë zjarri një 24-vjeçar

Lajmet | Operacionet

*06/11/2025*

# Kuçovë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Kompleks"

Kuçovë/Sekuestrohen armë zjarri, municion luftarak dhe lëndë narkotike kanabis.

Finalizohet operacioni policor i koduar "Kompleks".

Operacioni u zhvillua nga Komisariati i Policisë Kuçovë, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve dhe Forcën e Posaçme Operacionale të DVP Berat.

Kishte përshtatur lokalin për shpërndarjen dhe përdorimin e lëndëve narkotike, si dhe mbante armë zjarri automatik; vihet në pranga 41-vjeçari.

Ishte me masë sigurie "Arrest në shtëpi", për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike" dhe "Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt", si dhe mbante lëndë narkotike në banesë; vihet në pranga 27-vjeçari.

Në vijim të kontrolleve të ushtruara për identifikimin e autorit/ve të vendosjes së lëndës plasëse në një biznes ditën e djeshme, si dhe për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe të armëmbajtjes pa leje, pas informacioneve të marra në rrugë operative, në kuadër të operacionit "Kompleks", u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

K. K., 41 vjeç, banues në fshatin Drenovicë, Dimal;

K. Z., 27 vjeç, banues në fshatin Tapi, Kuçovë.

Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll në ambientet e lokalit që 41-vjeçari kishte në posedim, ku gjetën dhe sekuestruan:

1 armë zjarri automatik, një sasi lënde narkotike kanabis, 1 peshore elektronike, 30 fishekë luftarak.

Në vijim, u ushtrua kontroll në banesën e shtetasit K. Z., i cili ishte me masë sigurie "Arrest në shtëpi", ku u gjet dhe u sekuestrua një sasi tjetër lënde narkotike kanabis.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprime të mëtejshme.

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Foreign 3"

Tiranë/Zbardhet dinamika e ngjarjes së ndodhur dje, në Bathore, ku mbeti i plagosur me armë zjarri një 24-vjeçar

## Kërko

Enter a word for search

## Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

## Arkiva

Select Month

## Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2025 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.